



MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT TË TË FOLURIT TË FËMIJËS SHUMËGJUHËSH





Zhvillimi i të folurit të fëmijës shumëgjuhësh mund të avancojë në mënyrë të njëjtë sikur zhvillimi i të folurit të fëmijës një-gjuhësh. Zhvillimi i të folurit të fëmijës shumëgjuhësh megjithatë shpesh kërkon angazhim më të madh, që fëmija të mësojë të gjitha ato gjuhë të cilat dëshirojmë që ai fëmijë t'i mësojë.

Prindërit është mirë që fëmijës së tyre t'i flasin gjuhën e vet më të fuqishme dhe më të natyrshme: atë gjuhë, në të cilën mendon. Kështu edhe fëmija mëson gjuhë të pasur. Është me rëndësi që fëmija të ketë gjuhë funksionale me familje të vet, që bisedimi me familjen dhe farefisën të jetë i mundur edhe kur të rritet fëmija. Nëse në familje fliten më shumë se një gjuhë, është mirë që para se të lindet fëmija, të mendohet bashkërisht se cilën nga ato gjuhë shpresoni që ta mësojë fëmija. Rekomandohet që një i rritur t'i flet fëmijës gjuhën që e ka zgjedhur në mënyrë koherente. Nëse prindërit kanë gjuhët amtare të ndryshme, secili prind mund t'i flet fëmijës në gjuhë të vet.

Fëmija duhet të mund të dëgjojë dhe të përdorë mjaftueshëm ato gjuhë, të cilat shpresoni t'i mësojë fëmija. Nëse në përditshmërinë e fëmijës ka pak folës të gjuhës së tij shtëpiake, prindërit duhet të angazhohen më shumë rreth zhvillimit të gjuhës shtëpiake të fëmijës. Është me

rëndësi që gjuha që ushtrohet, të përdoret në mënyrë të shumëllojshme si p.sh.: përshëndetjet, pyetjet, komentimet, tregimet, shakatë, lutjet dhe shprehja e ndjenjave. Zotërimi i mirë i gjuhës së shtëpisë ndihmon edhe mësimin e gjuhës finlandeze. Nganjëherë fëmija dëgjon shumë gjuhën e shtëpisë por ka pak raste për të dëgjuar finlandishten. Atëherë është e rëndësishme që fëmijës t'i ofrohen më shumë mundësi për të ushtruar gjuhën finlandeze (p.sh: klubet e fëmijëve, aktivitetet e lira, shokët e lojërave).

Për nga aspekti i zhvillimit gjuhësor të fëmijës së cilësdo moshë, është e dobishme që fëmijës t'i flitet dhe që me të të bëjmë gjëra të ndryshme bashkërisht. Foli fëmijës edhe nëse ai/ajo kupton vetëm pak gjuhën e shtëpisë ose nuk di të përgjigjet. Fëmija mëson fjale të reja kura to të përsëriten mjaft shpesh në jetën e përditshme. Merre fëmijën bashkë në veprime të ndryshme të përditshmërisë, foli lidhur me gjërat që ndodhin në rrethinë, bisedo me fëmijën, përkujtoni gjërat e përjetuara bashkërisht, dëgjo fëmijën, luaj bashkë me të. Meqenëse fëmija mëson gjuhën më së miri në situata të vërteta, do të ishte mirë që fëmija të shikojë televizorin ose të përdorë celularin/tabletën vetëm një kohë të shkurtë gjatë ditës. Programet e TV-së dhe videot është mirë që të jenë në gjuhë amtare ose në gjuhë finlandeze.



Për nga aspekti i zhvillimit gjuhësor të fëmijës së cilësdo moshë, është e dobishme që fëmijës t'i flitet dhe që me të të bëjmë gjëra të ndryshme bashkërisht.

Foshnja dhe vogëlushi (0-2 v)

Foshnja e porsalindur nuk kupton gjuhë akoma, mirëpo të rriturit është mirë që t'i flasin foshnjës dhe të përgjigjen në tingëllimet edhe lëvizjet e foshnjës, që foshnja të interesohet për të folurit dhe komunikimin. Për foshnjën është me rëndësi që ajo të mund të hulumtojë botën së bashku me të rriturin. Është mirë që prindi t'i tregojë foshnjës për gjërat që bëhen gjatë përditshmërisë (p.sh. "tash po e ndërrojmë pelenën") dhe të emërtojë gjërat për të cilat ai/ajo është i interesuar. Foshnja kënaqet kur dëgjon këngë dhe vjersha si dhe kur prindi ndërron ngjyrën e zërit gjatë të folurit. Foshnja mëson të kuptojë fjalë para se të fillojë të flasë dhe ajo e shpreh veten duke qarë, duke tingëlluar dhe duke përdorur grimasa e shenja. Fjalët e para shfaqen zakonisht rreth moshës 1 vjeçare.



- Luani lojën "bo-o" ("peekaboo"). Mbulo fytyrën tënde ose të foshnjës me duar ose me shami, prit pak, heq duart/shaminë nga fytyra dhe thuaj gëzueshëm "bo-o".
- Hidhni ose rrokullisni topin te njëri-tjetri. Ndërtani bashkërisht kulla me blloqe lodra.
- Kur të fillojë fëmija të përdorë fjalë, zgjero të shprehurit e fëmijës (p.sh. kur fëmija bën me dorë nga vetura dhe thotë "vetura", i rrituri mund të thotë "Po, aty kalon vetura").
- Shikoni me fëmijën libra të thjeshtë me fotografi. Në fillim trego me gisht dhe emërtoja figurat fëmijës. Kur të fillojë fëmija të tregojë me gisht figurat, është me rëndësi t'i emërtoni ato figura. Pasi që fëmija të ketë filluar të thotë fjalët e para, mund të joshni fëmijën për të imituar p.sh. tingëllimet e shtazëve dhe fjalë tjera të lehta.
- Ushtroni bashkë lojëra mozaikë me pulla. Emërto figurat e mozaikut dhe komento rrjedhën e lojës (p.sh. "Të lumtë, e gjete vendin e rosës!").

Fëmija i moshës së lojës (rreth 2-5 v)

Në këtë moshë, të folurit e fëmijës zhvillohet me vull dhe bëhet të shumëllojshëm. Rreth moshës 2 vjeçe fëmija zakonisht fillon të lidhë fjalët dhe të prodhojë fjali të shkurta. Fëmija interesohet edhe më shumë rreth mjedisit dhe dalëngadalë fillon të kuptojë të folurit edhe kur nuk ndërlidhet drejtpërdrejt me situatën aktuale. Duke u rritur fëmija, edhe bisedat me të mund të bëhen më të llojllojshme. Fëmija kënaqet kur i rrituri shfaqë interesim rreth të bërave të tij. Mund ta merrni fëmijën në punët e vogla të përditshme dhe me fëmijën mund të bisedoni lidhur me ngjarjet në jetën e përditshme, mund të luani lojëra me imagjinatë si dhe lojëra tavoline.

- Lozni bashkërisht p.sh. me kukulla, me vetura, me shtazë, me enë lodra, me rroba rolesh ose me "lego". Fol me zë për çka ndodhë në lojë, thuaj fëmijës të tregojë rreth lojës dhe propozoj ngjarje të reja në lojë.
- Lexoni libra e figura, në të cilat ka një tregim të shkurtë. Bisedo me fëmijën rreth tregimit dhe pyet fëmijën rreth gjërave që janë në figura ose në tregim.
- Vizatoni dhe ngjyrosni bashkërisht. Tregoni çka po vizatoni dhe shpikni ndonjë tregim lidhur me figurën e vizatuar.
- Shëtisni jashtë dhe hulumtoni bashkërisht natyrën dhe mjedisin. Kërkoni p.sh. gurë, gjethe me ngjyra ose insekte dhe bisedoni rreth tyre.
- Lozni lojëra kujtese dhe lojëra tavoline, të cilat janë të përshtatshme për fëmijën. Ato mund t'i huazoni në bibliotekë.





Fëmija i moshës parashkollore dhe shkollore (6 v ->)

Fëmija tanimë flet me fjali të gjata dhe shqyrton dukuri të nduar-nduarshme, për shembull shkaqet dhe pasojat e gjërave. Fëmija mëson fjalë kuptimore, sikur "ndërmjet", "baras" dhe "më herët". Kur të afrohet fillimi i shkollës, me fëmijën mund të njoftohemi dalëngadalë me shkronjat dhe numrat. Shumë fëmijë e dhe më tej kënaqen duke lozur dhe nëpërmes lojës mësojnë gjuhë dhe shkathtësi shoqërore.

- Lexoni libra me tregime më të gjata. Pyet fëmijën lidhur me tregimin, duke përdorur pyetje "Pse". Shqyrtoni me fëmijën ndjenjat e personazheve të tregimit si dhe shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve. Bisedoni, se a ka fëmija përvoja të ngjashme si nga tema e lexuar.
- Luani lojëra fjalësh. Shpikni me radhë, p.sh. shtazë, fruta ose fjalë që fillojnë me germen A. Luani lojëra të sqarimit

të fjalëve, në të cilat njëri lojtar imagjinon ndonjë gjë dhe të tjerët përpiqen t'ia qëllojnë çka do të thotë ai/ajo (p.sh. "Junior Alias").

- Lozni lojëra, në të cilat duhet t'iu përmbaheni rregullave (p.sh. kile, fshehurazi).
- Kur flet me fëmijën, në të folurit tënd përdor fjalë përshkuese (p.sh.. "gëzueshëm", "i ndërlikuar") si dhe nocione të sakta të kohës dhe të vendit (p.sh. "**Pasnesër** do të shkojmë në pishinë", "Vendos lugët në kutinë e sipërme").
- Me shkollarin është mirë të bisedohet në gjuhë amtare/të shtëpisë lidhur me gjërat e mësuar në shkollë. Në atë mënyrë zgjerohet fjalori i fëmijës edhe në gjuhën e shtëpisë.

Çka nëse...

1. është vështirë që në përditshmëri të gjendet kohë për të ushtruar gjuhën e shtëpisë? Ushtrimet mund të përfshihen në të gjitha çastet e përditshmërisë. Për shembull gjatë përgatitjes së ushqimit dhe gjatë ngrënies me fëmijën mund të bisedohet për atë se, çka do të përgatisim për ushqim sot, ku i keni blerë artikujt ushqimorë, si përgatitet ushqimi, çfarë shije ka, si shtrohet tavolina dhe si pastrohet kuzhina. Nëse fëmija kalon kohën më të gjatë të ditës në kopsht me gjuhë finlandeze, mund të përpiqeni t'i gjeni fëmijës ndonjë aktivitet të lirë ose shoqëri të gjuhës amtare.
2. fëmija nuk e flet gjuhën e shtëpisë? Nganjëherë fëmija më me dëshirë flet gjuhën e mësuar në kopsht. Fëmijën nuk duhet detyruar ose t'i bëhet presion për të folur gjuhën e shtëpisë. Prindi megjithatë në mënyrë koherente duhet t'i flasë fëmijës në gjuhë të vet dhe t'i përsërisë në gjuhë të vet gjërat që i tregojnë fëmija. Mund ta shtoni interesimin e fëmijës për gjuhën e vet për shembull duke shikuar emisione për fëmijë në gjuhë të shtëpisë, duke mbajtur kontakte me farefisnin ose duke e njoftuar fëmijën me kulturën e familjes.
3. të folurit e fëmijës zhvillohet ngadalë ose fjalët e reja nuk i rrinë në kujtesë? Te disa fëmijë shfaqen vështirësinë zhvillimin e të folurit dhe në zhvillimin gjuhësor, megjithëse zhvillimi gjuhësor është mbështetur. Në asi rasti është mirë të drejtoheni te pedologu për vlerësim të gjendjes.

Potilasohje | Foniatrian yksikkö | Hyväksytty: Ahmed Geneid 9.6.2022



Kuvat: Pexels